Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 05.10.2026 nga Z. Tonin Prela bëjmë me dije si vijon:

Ankesa me numër 940057 është në trajtim me Platformën e Bashkëqeverisjes, pasi qytetari e ka rihapur më datë 21.9.2026, ku ka bashkëlidhur një kërkesë me shkrim drejtuar ASHK Shkodër-Pukë për objektin e tij të ankesës.
Po më datë 21.9.2026, ankesa është ridërguar për trajtim pranë ASHK Shkodër-Pukë dhe më datë 05.10.2026 qytetari është informuar se ankesa po vijon trajtimin me ASHK Shkodër-Pukë.
Më datë 12.10.2026 nga ASHK Shkodër-Pukë kemi marrë një përgjigje informuese përsa i përket objektit të ankesës në të cilën informohet qytetari si më poshtë vijon: "Për arsye të ndryshimit të VKM nr. 827 për shtëpitë e ndërtuara para vitit 1991 si dhe oborreve në përdorim, sipas Vendimit nr. 698, datë 16.09.2026 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 827 datë 30.09.2020 e Këshillit të Ministrave”, Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë të objekteve pa titull pronësie, trojeve funksionale dhe oborreve në përdorim”, nuk mund të procedojmë me afishimin e bërë, pasi VKM nr. 698 nuk lejon të përfitohet parcelë ndërtimore mbi 300 m2 dhe për arsye të ndryshimeve ligjore aplikimi në posedim të z.Tonin Prela do të ribëhet nga ana e specialistëve të DV ASHK Shkodër."
Kjo përgjigje informuese i është dërguar qytetarit dhe ankesa vijon të qëndrojë e hapur deri në përfundim të ribërjes së procedurave administrative të shprehura nga ASHK Shkodër-Pukë në lidhje me objektin e kërkesës së qytetarit.